

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT.: KPCC/D/C/111/2011
DATA E VENDIMIT: 13/05/2011

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në kërkesat nr. 00103 dhe 13070, Komisioni

vendos që

*Bartësi i të drejtës pronësore ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar;
dhe*

urdhëron që

*(a) Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit,
t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;*

*(b) Çdo person, i cili e ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30
(tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe*

*(c) Nëse pala përgjegjëse ose çdo person i cili e ka uzurpuar pronën
dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së
dhënë, të dëbohet nga prona;*

(2) Komisioni më tutje vendos që kërkesa nr. 00103 të hidhet poshtë për aq sa paraqitësi i kërkesës kërkon pronësinë për ndërtimin e ri të ngritur mbi pjesën e sipërme të pronës së kërkuar dhe kompensim për dëmin material, apo humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.

(3) Në kërkesat nr. 00256, 00842 dhe 01011, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke miratuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili miraton dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-

ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e dytë më 11 dhe 13 maj 2011 me anë të konferencës telefonike. Gjithsej i janë paraqitur Komisionit pesë kërkesa për pronë komerciale në seancën e njëzetë e dytë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

7. Ky vendim aplikohet për pesë kërkesa, pikërisht kërkesat nr. 00256, 00842, 00103, 01011 dhe 13070 në të cilat paraqitësi i kërkesës kërkon zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat komerciale.

8. Kërkesat nr. 00256 dhe 00842 janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndërsa kërkesat nr. 00103, 13070 dhe 01011 kanë qenë subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni ose për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve të tjera të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë zbuluar pasi vendimi ishte marrë. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara dhe korrigjimit të gabimeve të tjera të përpunimit. Dëshmitë dhe informacioni i ofruar nga çdo palë përgjegjëse e kërkesës ose çdo uzurpues aktual i pronave merren në shqyrtim nga Komisioni në rivendosjen e kërkesave. Në kërkesat, vendimet e mëparshme të cilave janë shfuqizuar nga Komisioni, Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar secilit paraqitës të kërkesave duke i informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar ata se kërkesat e tyre do të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara. Paraqitësit e kërkesave si dhe autoritetet kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

A. Kërkesa të hedhura poshtë.

9. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

10. Kërkesa nr. 01011 është jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Vendimet e marra për kërkesat e notifikuar gabimisht janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë e për t'i siguruar cilitdo personi i cili mund të ketë interes ligjor për pronën, mundësinë për t'iu përgjigjur kërkesës në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohej nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

11. Kërkesat nr. 00256 dhe 00842 janë kontestuese në kuptimin se pala që uzurpon pronat e kërkuara ("Pala përgjegjëse") ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme të procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

12. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

13. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

14. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të

ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit).

15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

1. Kërkesa nr. 00256.

16. Në kërkesën nr. 00256 paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e interesit pronësor dhe të drejtës së riposedimit për pronën e kërkuar. Prona ndodhet në Komunën e Gllgovcit ("Komuna"), në disa dokumente shkruhet si Drenas. Prona e kërkuar i ishte ndarë nga Komuna paraqitësit të kërkesës me afat të përkohshëm në vitin 1997. Në vitin 2001, Komuna e anuloi vendimin e mëparshëm të ndarjes bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal të Komunës ("Kuvendi Komunal") me anë të të cilit është miratuar një plan urban për ndërtimin e sheshit "Skënderbeu" në Komunë. Ky vendim ndikoi në pronën e kërkuar dhe paraqitësit të kërkesës iu hoqën dyqanet në vitin 2005 për ndërtimin e sheshit.

17. Janë dorëzuar një sërë dokumentesh nga paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës së tij duke përfshirë vendimet e ndarjes, vendimet administrative, vendime të gjykatave të ndryshme nga Gjykata Komunale, e Qarkut dhe Supreme e Kosovës dhe një letër nga ombudspersoni. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar vendimet e ndarjes dhe administrative të Kuvendit Komunal si edhe aktgjykimet e gjykatave të parashtruara nga paraqitësi i kërkesës. Nuk ka asnjë problem në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Çështja kyçe për Komisionin është ndryshe, nëse kërkesa bie në mandatin e Komisionit për të zgjidhur konteste pronësore që ndërlidhen me konfliktin e armatosur në Kosovë të 1998-99.

18. Vendimi i ndarjes i ofruar nga paraqitësi i kërkesës përcakton vetëm sipërfaqen kryesore të tokës jo sipërfaqen e përgjithshme të dyqaneve të cilat ekzistojnë më parë në këtë tokë. Vendimi i ndarjes përcakton gjithashtu se qëllimi për lejimin e ndarjes ishte për ndërtimin e objekteve komerciale. Komisioni e pranon se kjo është një dëshmi e mjaftueshme për natyrën komerciale të objekteve të kërkuara.

19. Komisioni është i kënaqur se të gjitha pronat e kërkuara të trajtuara në këtë vendim janë notifikuar si duhet në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni konsideron se janë bërë

përpjekje të arsyeshme që të njoftohen të gjitha palët që po ushtrojnë ose synojnë të drejtat pronësore ose edhe personat e tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor për pronën. Gjatë procesit të notifikimit, Sekretaria Ekzekutive konstatoi se pronat e kërkuara ishin të uzurpuara nga Kuvendi Komunal. Përfaqësuesi i autorizuar i Kuvendit Komunal z. Hakif Hasi, avokat publik komunal, nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes dhe kërkoi të drejtë ligjore në emër të Kuvendit Komunal i cili është pala përgjegjëse në këtë lëndë. Z. Hasi ka dhënë përgjigje për kërkesën në emër të palës përgjegjëse.

20. Pala përgjegjëse pohon se kërkesat duhet të hidhen poshtë se bien jashtë juridiksionit të Komisionit pasi paraqitësit e kërkesave nuk e kanë humbur posedimin si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë të vitit 1998-1999.

21. Në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, palës përgjegjëse i është ofruar një kopje e kërkesës të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Në përputhje me nenin 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësit të kërkesës, i është ofruar një kopje e dokumenteve të siguruara nga pala përgjegjëse në përgjigje të kërkesës. Si paraqitësit të kërkesës ashtu edhe palës përgjegjëse u është dhënë mundësia për të komentuar për informacionin e ofruar nga palët kundërshtuese dhe komentet apo informacioni i tillë janë marrë në konsideratë gjatë përpunimit dhe vendosjes së kërkesës.

22. Paraqitësit të kërkesës i ishin lëshuar fillimisht vendimet e ndarjes së pronave nga Kuvendi Komunal në vitin 1997. Vendimi i ndarjes i jepte paraqitësit të kërkesës të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit në ngastër për ndërtimin e dyqanit. Më 28 mars 2001, Kuvendi Komunal nxori një vendim me anë të të cilit autorizojë largimi i 60 strukturave i cili përfshinte dyqanin e paraqitësit të kërkesës, pasi këto ndërtime nuk ishin në përputhje me planin e ri urban.

23. Paraqitësi i kërkesës ankimoi vendimin e Kuvendit Komunal, i cili është shqyrtuar nga gjykata të ndryshme, përfshirë atë Komunale, të Qarkut, dhe Gjykatën Supreme të Kosovës si edhe institucione të tjera si Instituti i Ombudspersonit të Kosovës. Përfundimisht, Kuvendi Komunal konfirmoi vendimin e tij të vitit 2001 dhe dyqanet u larguan nga Komuna në vitin 2005. Paraqitësi i kërkesës informoi se humbi posedimin e dyqanit të tij në vitin 2005.

24. Nuk ka asnjë kontest për faktin se humbja e posedimit ndodhi pas konfliktit të armatosur në Kosovë të vitit 1999. Nuk është paraqitur asnjë argument nga paraqitësi i kërkesës në lidhje me atë se si humbja e të drejtave pronësore përfshin rrethanat e drejtpërdrejta të ndërldhura ose si pasojë e konfliktit të armatosur. Në këto rrethana, dhe në bazë të provave të regjistruara, humbja e të drejtave pronësore të paraqitësit të kërkesave nuk mund t'i atribuohet konfliktit, por është si rezultat i vendimeve për planifikimin urban të marra nga Kuvendi Komunal në vitin 2001. Vendimi i ndarjes përcaktonin se shfrytëzimi i tokës së ndarë ishte vetëm për qëllim të përkohshëm. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë mandatit të Komisionit ashtu si përcaktohet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës e ka kundërshtuar tashmë vendimin e Kuvendit Komunal para gjykatave vendore të cilat janë gjykatat e duhura për vendosjen e kontesteve pronësore që nuk ndërldhen me konfliktin e vitit 1998-1999

2. *Kërkesa nr. 00842*

25. Në kërkesën nr. 00842, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht i biri i bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore.

26. Babai i paraqitësit të kërkesës, bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore, nënshkroi kontratë shkëmbimi me Komunën e Vitisë në vitin 1992. Sipas kësaj kontrate, palët ranë dakord të shkëmbejnë një banesë të babait të paraqitësit të kërkesës me dyqanin e kërkuar të Komunës. Më vonë kjo marrëveshje është kundërshtuar nga Komuna dhe janë kryer procedura të ndryshme gjyqësore për këtë çështje në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Qarkut dhe Gjykatën Supreme të Kosovës. Si rezultat, kontrata në fjalë asnjëherë nuk është zbatuar, babai i paraqitësit të kërkesës asnjëherë nuk mori posedimin e pronës së kërkuar dhe asnjëherë nuk dha posedimin e apartamentit për shkëmbim. Rrjedhimisht, kontesti pronësor në fjalë, nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë mandatit të Komisionit si përcaktohet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës tashmë e ka paraqitur kontestin për marrëveshjen para gjykatave vendore të cilat janë forumi i duhur për zgjidhjen e kontesteve pronësore që nuk ndërlidhen me konfliktin e 1998-1999.

3. *Kërkesa nr. 01011*

27. Në kërkesën nr. 01011, paraqitësi i kërkesës deklaron se ai humbi posedimin e pronës në vitin 1970. Paraqitësi i kërkesës pretendon se dyqani është shpronësuar në vitin 1959 dhe u përfshi në asetet e ndërmarrjes në pronësi shoqërore.

28. Më pas, në vitin 2007, ndërmarrja në pronësi shoqërore u privatizua dhe prona u shit. Çështja tashmë ka qenë subjekt i procedurës para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës e cila e refuzoi padinë e bartësit të së drejtës pronësore si të pabazuar.

29. Në çdo rast, është e qartë se kërkesa e paraqitësit të kërkesës nuk ka lindur prej rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë mandatit të Komisionit ashtu si përcaktohet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

B. Kërkesa të miratuara.

30. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kerkese të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999..

31. Në kërkesën nr. 00103, paraqitësi i kërkesës ka parashtruar kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ka humbur

posedimin e pronës së kërkuar në qershor 1999 për shkak të konfliktit në Kosovë në atë kohë.

32. Komisioni vëren se kërkesa është jokontestuese në kuptimin se në kohen kur është bërë notifikimi i pronës së kërkuar, personi që kishte uzurpuar pronën nuk kërkoj të drejtë ligjore për pronën. Rrjedhimisht kërkesa mund të konsiderohet jokontestuese.

33. Paraqitësi i kërkesës ka ofruar kontratë blerje që ka të bëjë me pronën e kërkuar e cila mban datën 1995. Ky dokument është verifikuar si i vlefshëm nga Sekretaria Ekzekutive. Ndërkohë, uzurpuesi i paligjshëm ka ndërtuar një kat shtesë në krye të pronës së kërkuar. Ndërtimi është ngritur në krye të pronës së ndërtuar por nuk është bërë pjesë e pronës së kërkuar pasi është njësi e ndarë. Komisioni konsideron se ai nuk ka juridiksion për statusin ligjor të ndërtimit të ri pasi ai bie jashtë mandatit të Komisionit të parashikuar me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Kështu kërkesa duhet të hidhet poshtë në lidhje me ndërtimin e ri në krye të pronës së kërkuar.

34. Nga sa u tha më sipër, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon se:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) secila kërkesë është jokontestuese në kuptimin se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;
- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

C. *Kërkesat për kompensim*


35. Në kërkesën nr 00103, paraqitësi i kërkesës gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë

D. *Vërejtjet përmbledhëse.*

36. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar banesore.

37. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

38. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave ose mbajtësve të së drejtës pronësore për të kërkuar informacion për të drejtën e tyre pronësore për pronat e kërkuara, para autoriteteve vendore kompetente të tilla si organet kadastrale ose gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi. Ashtu si u theksua më sipër, shumë paraqitës të kërkesave kanë ndërmarrë këta hapa.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA00256	KPA00842	KPA00103	KPA01011	KPA13070		
----------	----------	----------	----------	----------	--	--